



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:226013  
Datë: 21.12.2020  
Numri i dokumentit: 01360064

C.nr.1014/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike kontestimore të paditësja H. Sh. nga P.. të cilin e përfaqëson e ëma e saj A..Sh.. si përfaqësuese ligjore tee cilat me autorizim i përfaqëson avokatin V. B nga P.. në këtë kontest gjyqësor, kundër të paditurës K .S “S.U. G A. ”, me seli në P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A. T , me objekt kontesti-kompensim dëmi, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më datë 19.11.2020, në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datë 04.12.2020, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësen H. Sh. nga P.. të cilën e përfaqëson e ëma e saj A. Sh. si përfaqësuese ligjore të cilat me autorizim i përfaqëson avokati V. B. nga P., ashtu që DETYROHET e paditura K.S “S. U . G . A”, me seli në P..., që paditëses në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës14.04.2014, t’ia paguaj shumat si në vijim:

1.Në emër të dëmit jo-material:

- a) Për thyerjen e klavikulës shumën 2,500.00€.
- b) Për shkak të shtypjes-ndrydhjes së krahut shumën 1,500.00€.

2.Për frikën e përjetuar:

- a) Për dhimbjet shpirtërore dhe friken e përjetuar shumën 1,000.00€.

3) Në emër të dëmit material:

- a) Për shpenzimet e mjekimit/ blerje të barnave, shumën 200.00€ (dy qind euro ).

**apo në shumën e përgjithshme në vlerë 5,200.00€** (Pesë mijë e dyqind euro), me kamatë 8% e cila llogaritet nga data e marrjes së këtij aktgjykimi 04.12.2020 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e dëmit, përtej shumave të gjykuara si në pikën I të dispozitiviti të këtij Aktgjykimi.

III. OBLIGOHET e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore, në shumën prej 1009.60€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas marrjes – plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me përmbarim.

## A r s y e t i m

### 1.Pretendimet e palës paditëse.

I autorizuari i paditëses me datë 05.05.2016, në këtë gjykatë ka parashtruar padi me të cilën ka theksuar se paditësja me datën 04.07.2015 është aksidentuar nga një automjet i tipit MAN-K.. me targa 01-9..-G.. të cilin e drejtonte B. G , i cili duke mos respektuar rregullat e komunikacionit godet të miturën H. Sh.- këtu paditësen, ku si pasoj e këtij aksidenti të njëjtës i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore si thyerje të klavikulës, shtypje e kraharorit-kontuzio dhe shkaktimin e frikës. I autorizuari i paditëse me datë 29.10.2015 ka bërë kërkesë tek e paditura për kompensimin e dëmit për lëndimet e pësuar, mirëpo e paditura ka ofruar shuma shumë të vogla e të cilat nuk i përgjigjen natyrës së dëmit dhe janë në kundërshtim me kontratën-policën e sigurimit.

Edhe në seancat gjyqësore i autorizuari i paditëse ka theksuar se mbetem në tërësi në thëniet e cekuar në padi, tutje ka kërkuar nga gjykata që të bëhet marrja e provës me ekspertizë të komunikacionit e cila do të vërtetonte bazën juridike, ndërsa për lëndimet e pësuar të paditëse ka kërkuar të bëhet marrje e provës përmes ekspertizës mjekësore. Propozimet e palës paditëse gjykata i ka aprovuar në seancën e date 26.06.2020 dhe ka caktuar ekspertet e fushave përkatëse të përpilimin e tyre.

Pas marrjes së ekspertizave i autorizuari i paditës ka bërë edhe precizimin e kërkesëpadiisë të cilën kërkesë-precizim gjykata e ka aprovuar. Në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata ka ftuar ekspertet mjekësore Dr. V. B -Ortopede dhe Dr. V. S-Psikiatre të cilat kanë dhënë sqarime shtesë lidhur me ekspertizën e përpiluar, tutje kanë shtuar se të e mitura nuk kemi vërejt ndonjë deformim që mund të këtë ardhur si pasoj e aksidentit dhe që mund të jetë deformim i përhershëm fizik, të njëjtat kanë shtuar se e mitura mund të këtë dhimbje të kohëpaskohshme dhe kjo ndodh me ndryshimin e motit. I autorizuari i palës paditëse në fjalën përfundimtare ka deklaruar se edhe në këtë stad të procedurës mbetem në tërësi pranë provave dhe parashtrimeve të paraqitura në këtë seancë dhe në seancat e kaluara, mbes në tërësi pranë precizimit të kërkesëpadiisë dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtën të aprovoj si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

### 2.Pretendimet e palës së paditur.

I autorizuari i të paditurës në përgjigje në padi ka deklaruar se e kontestojmë pjesërisht bazën juridike të kërkesë padisë sepse vlerësojmë se paditësja në cilësinë e drejtueses së çiklistes është përplasur për rrotën e pasme të kamionit dhe mban përgjegjësi primare. Për të vërtetuar këtë fakt të autorizuarit të paditëse i mbetet për obligim që të vërtetoj bazën juridike të kërkesëpadisë në aspektin e përgjegjësisë civile-juridike dhe i njëjti duhet të propozoj ekspertizë të komunikacionit në procedurë civile.

I autorizuari i të paditurës edhe në seancat e mbajtura gjyqësore ka deklaruar se kemi pranuar ekspertizën e komunikacionit, nuk kemi vërejtje dhe nuk ka nevojë që të dëgjohej eksperti për të dhënë sqarime shtesë. Sa i përket lartësisë të disa formave të kompensimit i kundërshtojmë në tersi pasi që nuk janë parapara në LMD-në. Kurse sa i përket frikës i njëjti ka deklaruar se e kontestojmë pjesërisht si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia sepse shumat e kërkuara në precizimin e kërkesëpadisë nuk kanë asnjë mbështetje në praktiken gjyqësore e as në Rregulloren e BQK-së. Lidhur me kamatën kërkojmë nga gjykata që të gjykoj në bazë të nenit 940 par.2 i LMD-së ku kamata rrjedh prej kohës kur vërtetohet demi, pra nga marrja e aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

### 3.Administrimi i Provave.

Me qëllime të vërtetimit të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike, Gjykata në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Konkestimore (LPK-së), administroi këto prova si në vijim:

- raporti i policisë i datës 01.07.2015 me nr.AR-15../2015,
- raporti i QKUK-see i datës 04.07.2015,
- ekspertiza e komunikacionit e datës 18.07.2015 dhe ekspertiza 29.11.2020,
- ekspertizën mjekësore e datës 08.09.2020,

Në kontestin e përgjithshëm të procedurës provuese lidhur me faktet vendimtare për përcaktimin e rrethanave të aksidentit dhe përgjegjësisë, gjykata i është referuar provave të administruara si në vijim:

-Nga Raporti i Aksidentit i datës 01.07.2015 me nr.AR-15../2015, gjykata konstatoi se me datën 14.10.2014, deri të aksidenti ka ardhur kur drejtuesi i automjetit Kamionit të tipi M... ishte duke u parkuar në skajin e rrugës dhe në atë moment fëmija ishte me biçikletë i cili e humb kontrollin mbi biçikletë dhe godet kamionin në gomën e majtë, ku si pasoj e mitura rrëzohet dhe të njëjtës i shkaktohen lëndime trupore.

-Nga ekspertiza e komunikacionit e datës 18.07.2015 është konstatuar se në bazë të materialit të prezantuar nga ana e Prokurorisë, vizitës se vendit të ngjarjes, në kuadër të kësaj ekspertize të komunikacionit në vijim do të analizohet rrjedha e aksidentit:

Sipas shikimit të vendit të ngjarjes deklaratave si dhe raportit të policisë vlen të theksohet se aksidentit i ka kontribuar automjeti "A" Kamion..., i cili në momentin kritik ishte duke drejtuar ngasësi B. G dhe duke mos pasur kujdes të shtuar gjatë parkimit të kamionit pasi që vendi i aksidentit ishte lagje e banuar dhe frekuentim i këmbësoreve është i shpeshtë, nga ky rast automjeti "B" që ishte çiklistja e humb kontrollin mbi çikletën dhe e godet kamionin në rrotën

e pasme të majte, ku nga ky aksident kemi lëndime trupore tek ngasësi i çiklistes H. Sh. e cila dërgohet në QKUK-në dhe pas tretmanit mjekësor lirohet për në shtëpi.

Sipas konstatimi dhe mendimi lidhur me aksidentin të dhënë në këtë ekspertizë dhe në bazë të materialit të prezantuar nga ana e Prokurorisë, analizës së rrjedhës së aksidentit të prezantuar me lartë eksperti ka konstatuar si në vijim:

- Aksidenti ka ndodhur me 04/07/2015 rreth orës 9:38 ne rrugën E.. lagjja A.. në P...,
- Është konstatuar se rruga ishte duke u punuar me kocka dhe ishte ende pa përfunduar,
- Është konstatuar se aksidenti ka ndodhur në rrugën vendbanim, pikërisht në lagjen A.. , E.. ,
- Është konstatuar se automjeti “A” nga pakujdesja gjatë parkimit godet automjetin “B”(çiklisten),
- Është konstatuar se dëme materiale nuk kishte, por vetëm lëndime trupore tek ngasësi i automjetit “B” që në këtë rast automjeti “B” ishte Çikleta ,
- Është konstatuar se rruga ishte e terur dhe e mirë,

Vlen të theksohet se aksidentit i ka kontribuar automjeti “A” duke bërë këto lëshime primare duke mos kushtuar kujdes të mjaftueshëm pjesëmarrëseve të tjerë në komunikacion pasi që vendi i aksidentit ishte në lagje dhe frekuentim në mes këmbësoreve është i shpeshte.

Vlen të theksohet se automjeti “A” i ka bere këto lëshime primare :

- Ka shkaktuar rrezikim të përgjithshëm në komunikacion,
- Nuk ka respektuar rregullat e përgjithshme të komunikacionit,
- Nuk posedon kategorinë përkatëse ne patente shofere për këtë lloj të automjetit.

-Nga ekspertiza e komunikacionit e date 29.11.2020 sipas analizës së dëmtimeve me kamion “A” dhe të deklaratës së shoferit, deri të kontakti i kamionit me biçikletën ka ardhur me pjesën e pasme të majtën e kamionit “A” në biçikletën B. Shoferi i kamionit “A” gjate lëvizjes ka për obligim që të verifikoj pjesëmarrësit tjerë në trafik, sidomos në pjesën e rrugës ku ishte në riparim dhe se përmes retrovizorit të jashtëm të majtë ka pasur mundësi të verifikoj dhe të shoh fëmijën me biçikletë, e cila ka ardhur nga ana e majtë e tij.

Në momentin e goditjes së biçikletës , kamioni “A” ka qenë në lëvizje, pra edhe vet shoferi deklaron se pasi e ka goditur biçikletën është ndalur. Dhe gjatë lëvizjes nuk ka verifikuar përmes retrovizorit se ka pjesëmarrës të tjerë në trafik, duke i rrezikuar ata. Po ashtu shoferi i kamionit A, në momentin e ndodhjes së aksidentit nuk ka pasur kategori ( në patën shofer ) për vozitje të kamionit që e ngiste. I njëjti ka poseduar vetëm kategorinë “B”.

Në bazë të rregullave të trafikut, çiklisti gjatë drejtimit duhet ta shfrytëzoje shiritin për biçikleta ose shtegun e përbashkët për biçikleta dhe këmbësore. Kur nuk ekziston shtegu apo shiriti për biçikleta ose shtegu i përbashkët për biçikleta dhe këmbësorë, çiklisti duhet ta shfrytëzoj bankinën dhe nëse kjo nuk është e mundur ta shfrytëzojnë shiritin e djathte, duke lëvizur sa ma afër skajit të djathte në distance deri në një metër.

Fëmijët me të ri katërmbëdhjetë (14) vjeç nuk i lejohej ta drejtoje biçikletën në rrugë publike, përjashtimisht fëmijët të cilët i kanë mbushur 10 vjet, të cilët në shkolle aftësohen të drejtojnë çikletën në rrugë, për këtë lëshohet vërtetim, munden vet ta drejtojnë çikletën në rrugë lokale,

ndërsa fëmijët të tjerë nuk mund ta drejtojnë çikletën mbi moshën 9 vjeçare nën përcjelljen e nje personi i cili i ka mbushur 16 vjet.

Mundësia e evitimit të aksidentit-Deri të ky aksident nuk do të vinte sikur shoferi i kamionit “A” gjatë lëvizjes me kamion, të verifikonte trafikun në pjesën e pasme të kamionit duke verifikuar retrovizorin e jashtëm të majtë, me atë rast do ta vërente biçikletën (fëmijën 6 vjeç) në trafik.

Eksperti si përfundim ka konstatuar se duke u bazuar në shkresat e lëndës, dhe pas sigurimit të komplet shkresave penale të këtij rasti, pas analizës detale kam ardhur në përfundim se :

-Ky aksident i komunikacionit rrugor ka ndodh me date 04.07.2015 , rreth orës 9:38 në lagjen “A... “ në E.. P....

-Në kohën e ndodhjes së aksidentit , ka qenë ditë, dukshmëri e mirë. Rruga ka qenë në punim e sipër.

-Deri të ky aksident i komunikacionit rrugor kishte ardhur, përderisa shoferi me kamionin ”A” ishte duke lëvizur në Lagjen A.. në E.. ku ishte duke u bërë rregullimi i rrugës të kësaj lagje.

-I njëjti manovron me automjet për ta parkuar kamionin në skajin e rrugës dhe në atë moment nuk e vëren fëmijën me biçikletë që ishte në rrugë dhe fëmija me biçikletën e tij frikësohet ku e humb kontrollin në biçikletë dhe e godet gomën mbrapa të anës së majtë të kamionit, ku fëmija merr lëndime trupore.

-Në kamion nuk vërehen dëmtime të dukshme, ndërsa çiklistja pëson lëndime të rënda trupore .

-Në vendin e ngjarjes nuk janë evidentuar gjurmë të frenimit apo gjurmë të tjera të dukshme të lëvizjes së kamionit.

-Duke u bazuar në faktin se rruga ka qenë e pa ndërtuar dhe duke u riparuar me kupëza betoni, kamioni nuk ka mundur të zhvillojë shpejtësi të madhe, dhe jo me shume se 20-30 km/h.

-Deri të ky aksident nuk do të vinte sikur shoferi i kamionit “A” gjatë lëvizjes me kamion, të verifikonte trafikun në pjesën e pasme të kamionit duke verifikuar retrovizorin e jashtëm të majtë, me atë rast do të mund të vërente biçikletën ku do të mund të evitonte aksidentin.

-Çiklistja (fëmija 6 vjeç) në momentin e ndodhjes së aksidentit ka qenë duke ngarë biçikletën në rrugë publike pa e arritur moshën e parapare në bazë të rregullave mbi komunikacion, si dhe pa prezencën e personit madhor në rrugë.

Pra sipas vlerësimit të ekspertit deri të ky aksident i komunikacionit rrugor ka ardhur si shkak i lëshimeve kryesore të shoferit të kamionit “A” (M..) me targa :01-9..-C.. me veprimet e tij ka bërë lëvizje e pasigurt me mjet në rrugë publike, duke mos pasur kujdes ndaj pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, ku gjatë lëvizjes dhe manipulimit me automjet në pjesën e sipërfaqes së rrugës e cila ishte në ndërtimin e sipërm, nuk e vëren me kohë biçikletën (fëmijën 6 vjeç) të cilën e godet, dhe përplasë në tokë.

Këtij aksidenti i ka kontribuar edhe çiklistja ( fëmija 6 vjeç) me ngasje të pasigurte të biçikletës në rrugë publike, e cila momentin e ndodhjes së aksidentit ende nuk e kishte arritur moshën e parapare ( për të drejtën e lëvizjes me biçikletë në rrugë publike ), si dhe ka qenë në rrugë pa prezencën e personit madhor.

-Nga raporti mjekësor i QKUK-së i datës 04.07.2015, konstatohet se e paditësja i është nënshtrua një tretmani mjekësor emergjent në QKUK-në, ku sipas mjekëve paditësja ka frakturë të klavikulës dhe lëndime të tjera të cilat lëndime duhet të shoqërohen me terapi adekuate.

-Nga ekspertiza mjekësore e përpiluar nga mjeket e lëmvive përkatëse është konstatuar se Paditësja e mitur H. Sh.. në aksident trafiku të datës 04.07.2015 ka pasur këto lëndime trupore :

- Ndrydhje e krahut te majte,
- Gërvishtje e regjinit te krahut te majte,
- Thyerje e kallvikulës së majtë e pa dislokuar,

Këto lëndime bëjnë pjese në lëndime të rënda trupore. E lënduari ka përjetuar dhembje fizike dhe atë :

- Dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë – 1 orë duke marrë parasysh vendndodhjen e aksidentit e deri në marrjen e ndihmës së parë respektivisht analgjetikeve në Qendrën Emergjente.
- Dhembje fizike të intensitetit të rëndë – 2 ditë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë dhe atë dhimbje në regjionin e klavikulës së majtë dhe regjionin e krahut të majtë.
- Dhembje fizike të intensitetit të mesëm – 21 ditë kohë të nevojshme për ramjen e edemes dhe hematomës dhe formimit të kallusit primare në regjionin e klavikulës së majtë si dhe dhimbje në regjionin e gërvishtur të krahut të majtë.
- Dhimbje fizike të intensitetit të ulët – që posedon edhe sot në sforcime fizike, ngritje të krahut të djathtë, bartje të peshës dhe ndërrimeve të motit

Paditësi përveç lëndimeve trupore ka manifestuar edhe frike dhe atë:

1.Frika primare e cila ka zgjatur disa sekonda dhe nënkupton momentin e aksidentit kohën brenda kësaj kohe ka përjetua ndjenjën e përfundimit fatal – frikë nga vdekja.

2. Frikë sekondare e cila nënkupton prishjen e stabilitetit psiko-social, pa e parashikuar fare, aktivitetin shtesë për shkak të dëmtimeve të pësuar, që manifestohen me ankthin, preokupimin me kontroll dhe procedura mjekësore, të cilat kanë bërë që të ndihet keq në aspektin psikik si dhe frikën rreth pasojave eventuale. Të gjitha këto kualifikohen si :

a) Frika sekondare e intensitetit mesatar e cila ka zgjat rreth katër javë dhe nënkupton reperkusionet dhe përpjekjet psikike dhe fizike që gjendja të përballohet dhe të përmirësohet. E njëjta ka pas shumë peripeci dhe sfida gjatë trajtimit mjekësor. Ky trajtim e ka lodhur psikikisht dhe fizikisht, pastaj kanë ekzistuar dilemat për prognozën, shërimin dhe pasojat në raport me aksidentin. Po ashtu ka manifestuar ankth, çrregullim të ritmit të gjumit (zgjime të shpeshta gjatë natës) siklet , inkontinencë emocionale si dhe pengesat e paraqitura lidhur me kryerjen e rutinës së përditshme.

c) Frika në intensitet të ulët e cila ka zgjatur 4 muaj manifestuar me simptomat lartpërmendura por me intensitet me të ulur si dhe shqetësimet të cilat riperkutohen në relacionet kardiorespiratore ankesave somatike dhe të cilat kanë interferuar në reduktimin e raporteve familjare dhe shoqërore.

E lënduara nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë pasi që ka pasur thyerje pa dislokim (zhvendosje) të klavikulës si dhe bazuar në moshën e re 7 vjeçare ku ngjitja dhe riparimi është i shpejte. E lënduari nuk ka shëmtim trupore, i është nevojitur ndihma nga personi i tret në kohëzgjatje prej 4 javë sa ka mbajtur mobilizim dhe atë ndihme në veshmbathje dhe mbajtjen e

higjienës personale dhe kryerjen e aktiviteteve te përditshme jetësorë. Të lënduarës i është nevojitur ushqim i përforcuar në kohëzgjatje prej 8 jave dhe atë ushqim i pasur me proteine, minerale dhe vitamine, të njëjtës i është nevojitur terapi fizikale në kohëzgjatje prej 10 ditësh për forcim të muskujve të regjionit të krahut të djathte dhe muskujve të shpinës.

#### 4.Gjendja e vërtetuar faktike.

Gjykata pasi e administroi secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku ashtu si u përshkrua në pjesën e pestë (5) të arsyetimit të këtij aktgjykimi, në kuptim të nenit 8 të LPK-së , Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike dhe atë: Në bazë të të dy ekspertizave të komunikacionit të punuara nga Ekspertet përkatës vërtetohet se nga shikimi i vendit të ngjarjes, deklaratave të palëve prezentë, si dhe raportit të policisë në aksidentit e ndodhur, ka kontribuar automjeti “A” K.. M...i cili në momentin kritik ishte duke drejtuar ngasësi-i siguruari i të paditurës, i cili duke mos pasur kujdes të shtuar gjatë parkimit të kamionit godet të miturën Hana Shala këtu paditësen e cila pas aksidentit dërgohet në Spital për trajtim mjekësor. Gjykata nga ekspertizat e komunikacionit vërtetoj se drejtuesi i automjetit A ka kontribuar në këtë aksident, nuk ka pasur kujdes të shtuar, pasi që vendi i aksidentit ishte lagje e banuar dhe frekuentim i këmbësoreve ishte i shpeshtë. Po ashtu edhe nga ekspertiza e datës 08.09.2020 vërtetohet se deri të ky aksident i komunikacionit rrugor ka ardhur si shkak i lëshimeve kryesore të shoferit të kamionit “A” (M..) me targa :01-9.-C.. i cili me veprimet e tij ka bërë lëvizje e pasigurt me mjet në rrugë publike, duke mos pasur kujdes ndaj pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, ku gjatë lëvizjes dhe manipulimit me automjet në pjesën e sipërfaqes së rrugës e cila ishte në ndërtimin e sipërm, nuk e vëren me kohë biçikletën (fëmijën 6 vjeç) të cilën e godet, dhe përplasë në tokë. Sipas vlerësimit të eksperteve se në këtë aksidenti ka kontribuar edhe çiklistja ( fëmija 6 vjeç) me ngasje të pasigurte të biçikletës në rrugë publike, e cila momentin e ndodhjes se aksidentit ende nuk e kishte arritur moshën e parapare (për të drejtën e lëvizjes me biçikletë në rrugë publike ), si dhe ka qenë në rrugë pa prezencën e personit madhor, kësaj pjese të ekspertizës gjykata nuk ia fali besimin sepse ekspertet në një pjesë të ekspertizës elaborojn shumë qartë se drejtuesi i Kamionit nuk ka pasur kujdes të shtuar gjatë lëvizjes mbrapa, nuk ka shikuar retrovizorët e kamionit për të vërejtur se ka fëmijë në rrugë, për me tepër ekspertet konstatojnë se drejtuesi i kamionit nuk ka pasur kategori adekuate për të drejtuar Kamionin por ka pasur vetëm patentë shofer të kategorisë “B”, madje në ekspertizë nuk është përcaktuar përqindja e kontributit në aksident, andaj ekspertizave të Komunikacionit, gjykata ia fali besimin vetëm në bazë të konstatimeve të eksperteve të cilët vërtetojnë përgjegjësin e shkaktarit të aksidentit i cili në rastin konkret u vërtetua se shkaktar ishte drejtuesi i Kamionit M.. ( automjet i siguarur të e paditura).

Ekspertizën mjekësore të ekspertëve, për sa i përket dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar të paditëses respektivisht dëmit jo material, gjykata e mori në tërësi si të bazuar për llojet e dëmit të kërkuar në kërkesëpadi sepse ekspertiza përmban elemente të nevojshme, me të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme, të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje juridike kontestimore.

#### 5.Vendimi i Gjykatës.

Provat e administruara si më sipër, të cilat i referohen rrethanave dhe vendit të aksidentit si dhe ato të cilat, i referohen natyrës dhe shkallës së lëndimeve të paditëses, gjykata i pranoj në grupin e provave jo kontestuese. Në të vërtetë, nuk ishte për asnjërën palë kontestues fakti se paditësja vërtetë ka pësuar dëm nga aksidenti, nuk ishte kontestues fakti se në bazë të ekspertizave të komunikacionit drejtuesi i automjetit ishte fajtor për aksidentin e shkaktuar. Këto fakte gjykata i vërtetoi pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike. Pretendimet e përfaqësuesit të të paditurës, se aksidenti i ndodhur ka ardhur edhe si pasojë e kontributit të paditës dhe të paditurës nuk mund t'i ngarkohet përgjegjësia e plotë për dëmin e shkaktuar në rastin konkret, prandaj duhet të aplikohen dispozitat mbi bazat e përgjegjësive sipas fajit, duke bërë ndarjen e përgjegjësive, respektivisht kompensimin e dëmin në proporcion me fajin e të paditurës, gjykata i konsideron si të papranueshme për rastin konkret, për shkaqet në vijim:

Për dëmet nga sendet e rrezikshme siç është automjeti në lëvizje, rreziku dhe përgjegjësia supozohen andaj çdo dëm i pësuar nga këto sende bie në përgjegjësi të zotëruesit të sendit të tillë. Lidhur me këtë në nenin 154 të LMD-së, thuhet se *“Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit”*. Prandaj, bazuar në këtë nen dhe nenin 158 paragrafët 1 dhe 2 të LMD-së, përgjegjësia e të paditurës për dëmin e shkaktuar mund të largohet nga ajo, vetëm nëse e paditura e provon se përkundër faktit se i siguruari i saj (drejtuesi i automjetit) i ka marrë të gjitha masat e duhura, dëmi nuk do të mund të mënjanohej në asnjë mënyrë, respektivisht duhet ta provojë se dëmi ka ndodhur absolutisht pa fajin e tij dhe se ajo nuk ka mundur ta parashohë dhe ta parandalojë, si dhe të provojë se dëmi ka ndodhur ekskluzivisht me fajin dhe nga veprimet e paditësit, andaj pretendimet e të paditurës janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuar në ligj.

Meqenëse në rastin konkret e paditura nuk ka ofruar asnjë provë më të cilën do ta vërtetonte se ajo nuk është përgjegjëse për dëmin, Gjykata iu referua nenin 155, të LMD-së, i cili parasheh se, *“ Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të;* andaj gjykata vlerësoi se e paditura është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar paditëses.

Meqë në rastin konkret është vërtetuar se, dëmi i cili është objekt i kërkesëpadisë, është shkaktuar me fajin e të siguruarit të të paditurës, gjykata duke u bazuar në Rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), konkretisht neni 32 dhe 33 i kësaj Rregullore thuhet se përgjegjësia për kompensimin e dëmit bie mbi të paditurën, andaj gjykata në aplikim të këtyre dispozitave ligjore dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurin që paditëses, t'ia kompensoj dëmin e pësuar, në shumat e gjykuara.

Duke ju referuar lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata e aprovoi atë pjesërisht, duke pasur parasysh bindjes së saj të lirë, mendimin e eksperteve mjekësor, provat e ofruara nga palët, moshën e re të paditëses dhe natyrën e lëndimeve, shkallën e dhimbjeve dhe frikës së përjetuar, të cilat padyshim se paditëses i kanë shkaktuar dëme materiale dhe jo materiale, dhimbje shpirtërore dhe fizike.



Gjykata, ka refuzuar kërkesëpadinë mbi shumat e gjykuara për paditësen sepse ka vlerësuar se po të caktoheshin shuma më të larta se ato të gjykuara nuk i përgjigjen shkallës së frikës, dhimbjeve fizike dhe shpenzimeve të mjekimit.

Meqenëse e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e dëmit të krijuar, e duke u bazuar në nenin Nenit 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), gjykata e detyroj të paditurin që t'ua paguaj paditësve, shumat e gjykuara të kompensimit së bashku me normën e kamatës, në lartësi prej 8%, që nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, e deri me pagesën definitive. Lartësia e kamatës në rastin konkret, i referohet shkallës së kamatës, nga nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi, dhe atë për padi 104.00€, për përfaqësim në tri seanca nga  $135.20 \times 3 = 405.60$ €, për ekspertizë mjekësore shumën prej 300€, për ekspertizën komunikacionit 150€, taksën gjyqësore për padi 50,00€, të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 1,009.60 €.

Prandaj, nisur nga të lartcekurat dhe duke ju referuar nenit/eve 4, 5, 7, 8 dhe 10 lidhur me nenin 143 dhe 146 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
C.nr.1014/16, me datë 04.12.2020

Gjyqtari,  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.